

PULLE TARIFE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.500 Rregjistri Themeltar

Datë 04.02.2014 rregjistrimi

Nr. 523 Vendimi

Datë 06.03.2014

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS ”

Gjykata Administrative e Apelit e përbërë nga gjyqtarët:

Kryesuese : Altina NASUFI

Anëtare : Lindita SINANAJ

Anëtar : Artur MALAJ

-nën asistencën e sekretares gjyqësore [REDACTED] në Tiranë në datë 06.03.2014 mori në shqyrtim ne dhomë këshillimi, çështjen administrative me nr.500 rregjistri themeltar, datë 04.02.2014 rregjistrimi me palë ndërgjyqëse:

PADITËSE:

[REDACTED] e bija e [REDACTED] e datëlindjes [REDACTED]
banuese në rrugën [REDACTED], pall [REDACTED] shk [REDACTED] ap [REDACTED]

I PADITUR :

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

OBJEKTI :

Shfuqizimi i vendimit Nr.2167, datë 09.08.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe kthimin e paditëses në detyrën e mëparshme, duke paguar diferencën e pagës deri në zbatimin e vendimit.

BAZA LIGJORE : Neni 8, pika 3 i Ligjit Nr.8549, dt.11.11.1999 "Statusi i Nëpunësit Civil" dhe nenet 328, 442, 442/a të K.Pr.Civile.

Komisioni i Shërbimit Civil me vendimin nr.179, datë 20.09.2013 ka vendosur :

- Pranimin e ankesës së zj. [REDAKTUAR]
- Shfuqizimin e vendimit nr.2167, datë 09.08.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve "Për emërim në detyrë".
- Rikthimin e ankueses në detyrën e mëparshme, si inspektore e parë në Drejtorinë e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Kryerjen e diferencës së pagës së ankueses midis dy pozicioneve të punës, nga momenti i aplikimit të vendimit nr.2167, datë 09.08.2013 e deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi.

Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit të KSHC-së, rrëzimin e kërkesës së ankueses [REDAKTUAR] dhe lënien në fuqi të vendimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.29 datë 15.01.2014 ka vendosur:

- Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Apelit Tiranë për gjykimin e çështjes me nr.198 akti, me paditës [REDAKTUAR] e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me objekt: "Shfuqizimi i vendimit nr.2167 datë 09.08.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve dhe kthimin e paditëses në detyrën e mëparshme, duke paguar diferencën e pagës deri në zbatimin e vendimit" dhe dërgimin e akteve Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, si gjykatë kompetente.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

në dhomë këshillimi, pasi dëgjoji relatimin e gjyqtares Altina Nasufi, shqyrtoi të gjitha aktet shkresore dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N

I.Rrethanat e çështjes:

1. Padiësja ka krijuar mardhënien juridike të punës me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve që në dhjetor të vitit 1995 dhe së fundmi ka kryer në detyrën e Inspektorës së Parë pranë kësaj Drejtorie.

2. Me urdhrin nr.2167 datë 09.08.2013 ajo është liruar nga kjo detyrë dhe është emëruar në detyrën inspektore të dytë në Sektorin e Verifikimit në Terren në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë.

3. Duke mos qënë dakord me vendimin për emërimin në këtë detyrë, padiësja ka ushtruar të drejtën e ankimit në Komisionin e Shërbimit Civil duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.2167 datë 09.08.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, kthimin në vendin e mëparshëm të punës si dhe pagimin e pagës deri në momentin e rikthimit në vendin e mëparshëm të punës.

4. Padiësja ka pretenduar se vendimi për emërimin në një detyrë tjetër është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, pasi nuk është respektuar forma dhe procedura e kërkuar nga ligji, nuk është specifikuar dispozita e ligjit 8549/1999 për këtë levizje, vendimi është i pamotivuar sepse ajo ka patur rezultate shumë të mira në punë.

II. Vlerësimi i Komisionit të Shërbimit Civil:

5. Pasi ka shqyrtuar ankimin e paraqitur nga padiësja, duke i gjetur të bazuara në prova dhe në ligj pretendimet e saj, me vendimin nr.179, datë 20.09.2013 Komisioni i Shërbimit Civil ka vendosur:

-Pranimin e ankesës së zj [REDACTED]

-Shfuqizimin e vendimit nr.2167, datë 09.08.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve "Për emërim në detyrë".

-Rikthimin e ankueses në detyrën e mëparshme, si inspektore e parë në Drejtorinë e Apelit Tatimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

-Kryerjen e diferencës së pagës së ankueses midis dy pozicioneve të punës, nga momenti i aplikimit të vendimit nr.2167, datë 09.08.2013 e deri në ekzekutimin e plotë të këtij vendimi.

5.1. Komisioni i Shërbimit Civil pasi ka konstatuar se padiësja e gëzon statusin e nëpunësit civil, ka argumentuar ndër të tjera se: "...Ankuesja ka punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të

Tatimeve si Inspektore e Parë që i përkon kategoria III-b dhe me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve është ulur në kategorinë IV-a gjë e cila reflekton ulje në pagë.

5.2 Duke ju referuar VKM nr.1184 datë 20.08.2008, të vetmet mënyra të plotësimit të vendit të lirë në këtë administratë janë: 1) me transferim brenda të njëjtës kategori; 2) me ngritje në kategori nëpërmjet konkurimit të personelit ekzistues; 3) me konkurim të hapur.

5.3 Me rastin e lëvizjes në detyrë të ankueses, nuk është respektuar asnjëra nga këto tre mënyra. Sipas VKM nr.1184 datë 20.08.2008, transferimi i nëpunësve të administratës tatimore nga një pozicion në tjetrin duhet bërë në përputhje me nenin 17 të ligjit nr.8549 datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

III. Shkaqet e ngritura në ankim nga pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

6. Pala e paditur në ankimin e paraqitur ka kërkuar anulimin e vendimit nr.179 datë 20.09.2013 të Komisionit të Shërbimit Civil dhe lënien në fuqi të vendimit nr.2167 datë 09.08.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve me këto argumente:

6.1 Vendimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve është i bazuar në prova dhe në ligj dhe konkretisht në nenet 19 dhe 20 të ligjit 9920 datë 18.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në ligjin nr.8549 datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", Urdhrin e Kryeministrit me nr.130 datë 06.11.2012 "Për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të punonjësve të administratës tatimore qendrore" si dhe urdhrin nr.70 datë 13.12.2012 të Ministrit të Financave "Për miratimin e organigramës së punonjësve të administratës tatimore qendrore".

6.2 Ky vendim është marrë brenda kompetencave ligjore të autoritetit epror dhe në përputhje me formën dhe procedurën e parashikuar nga ligji nr.9920 datë 18.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

6.3 Bazuar në nenin 22 pika 2/c e ligjit nr.9920 datë 18.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, është titullari i institucionit që me nismën e tij gjykon dhe

vendos për largimin dhe lëvizjen në detyrë nga shërbimi civil të punonjësve, në funksion të detyrave të tij funksionale, mbarëvajtjes së punës institucionale, reformimit ndërsektorial, etj.

IV. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit.

7. Gjykata kryesisht konstatoi se çështja përbën lëndë juridiksioni gjyqësor dhe se ajo hyn në kompetencën e saj lëndore dhe funksionale për gjykim bazuar në nenet 7, 9 dhe 10 të ligjit nr.49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative"*.

8. Në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, gjykata vlerëson se ankimi është paraqitur në Gjykatën e Apelit konform nenit 8, pika 3 e ligjit nr.8549 datë 11.11.1999 *"Statusi i nëpunësit civil"*, nga subjekti i legjitimuar pasivisht dhe brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar nga kjo dispozitë.

8.1 Në përputhje me interpretimet ligjore të bëra me Vendimet Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr.3 datë 24.01.2007, nr.20 datë 15.11.2007 dhe nr.1 datë 17.01.2011, shqyrtimi i çështjes u bë sipas procedurave të gjyimit në apel (dhomë këshillimi) sipas nenit 49 të ligjit nr.49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative"*.

i) legjislacioni i zbatueshëm:

9. Në lidhje me shkaqet e ngritura në ankim, paditësja bën pjesë në nomenklaturën e nëpunësve të administratës tatimore qendrore sipas parashikimeve të nenit 13/1 e ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 *"Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë"*. Për të gjykuar mbi ligjshmërinë e vendimit nr.2167 datë 09.08.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve "Për emërimin në detyrë" të paditëses, gjykata çmon të evidentojë aktet ligjore dhe nënligjore që kanë bërë rregullimin juridik të statusit të nëpunësit civil, rastet ligjore të lëvizjes nga detyra të tij, respektimin e procedurës së kërkuar nga ligji dhe kompetencat funksionale të drejtuesit të administratës qendrore në këtë drejtim.

9.1 Në nenin 17 të ligjit nr.8549 datë 11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit civil*", me propozimin e institucionit që ka vendin e lirë të punës ne raste të nevojës së perkohshme, Departamenti i Administratës Publike për institucionet e administratës qendrore ose departamentet e personelit për institucionet e pavarura, do të përcaktojë nëse justifikohet një transferim i detyrueshëm. Nëse një nevojë e tillë ekziston, nëpunësit civil mund t'i kërkohet të transferohet në një detyrë tjetër të të njëjtit nivel dhe kategori. Keto transferime zgjasin për një periudhë deri në gjashtë muaj. Nëpunësi civil nuk mund të detyrohet të pranojë transferimin nëse vendi i ri i punës është më larg se 30 km nga vendi i punës aktual.

9.2 Sipas pikës 12.1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.1184 datë 20.08.2008 "*Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit e të emërimit, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e administratës tatimore qendrore*" transferimi i detyrueshëm brenda së njëjtës kategori për punonjësit e administratës tatimore realizohet në përputhje me nenin 17 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit civil*", sipas procedurave për institucionet e pavarura.

9.3 Neni 22 i ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar, ka parashikuar kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve në procedurën disiplinore për nëpunësit e administratës tatimore qendrore, duke iu referuar legjislacionit të shërbimit civil (neni 17 i ligjit në fjalë).

ii) analiza ligjore e fakteve dhe e provave:

10. Si në ligjin nr.8549 datë 11.11.1999 "*Statusi i nëpunësit civil*" ashtu edhe në aktet nënligjore të dalë në zbatim të tij, janë mishëruar parimet e shërbimit civil duke e konceptuar atë *si shërbim profesionalizmi ndaj publikut që bazohet në parimin e vazhdimësisë së karrierës të nëpunësve civilë*. Kjo është arsyeja që ligji ka parashikuar një procedurë specifike për trajtimin e nëpunësve civilë duke mbajtur në konsideratë statusin e posaçëm të njohur dhe të fituar prej tyre për shkak të ligjit në funksion të ushtrimit prej tyre të autoritetit publik.

11. Mirëfunksionimi i administratës tatimore dhe respektimi në mënyrë rigoroze i legjislacionit fiskal, është një nga faktorët që ndikon ndjeshëm në rritjen e të ardhurave buxhetore. Duke mbajtur në konsideratë specifikat e pozicionit të punës të punonjësve të administratës tatimore,

specifikisht asaj qendrore, ligji i posaçëm nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedura tatimore në Republikën e Shqipërisë" ka konsakruar si një nga parimet e administrimit tatimor: rekrutimin, trajnimin dhe ngritjen në detyrë të punonjësve tatimorë që me integritet moral dhe profesional zbatojnë me korrektësi ligjin dhe aktet nënligjore, duke ju dhënë atyre ligjërisht një garanci më shumë në detyrë.

12. Duke analizuar faktet konkrete vërehet se nga pala e paditur nuk është zbatuar procedura e lëvizjes në detyrë që parashikon ligji i posaçëm. Padiësja ka punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve si Inspektore e Parë që i përkon kategoria III-b dhe me Vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve është emëruar si inspektore e dytë, që për efekt klasifikimi trajtohet me kategorinë IV-a të nëpunësit civil, gjë e cila reflekton ulje në pagë.

13. Duke ju referuar VKM nr.1184 datë 20.08.2008, të vetmet mënyra të plotësimit të vendit të lirë në këtë administratë janë: 1) me transferim brenda të njëjtës kategori; 2) me ngritje në kategori nëpërmjet konkurimit të personelit ekzistues; 3) me konkurim të hapur.

14. Me rastin e lëvizjes në detyrë të padiësës, nuk është respektuar asnjëra nga këto tre mënyra. Sipas VKM nr.1184 datë 20.08.2008, transferimi i nëpunësve të administratës tatimore nga një pozicion në tjetrin duhet bërë në përputhje me nenin 17 të ligjit nr.8549 datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", vetëm në kushtet e transferimit të detyrueshëm brenda të njëjti nivel dhe kategori, për një periudhë të përkohshme. Ky parashikim ligjor nuk është respektuar nga pala e paditur.

15. Për të gjitha argumentimet ligjore të lartëcituar, vendimi nr.2167 datë 09.08.2013 i Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve është marrë në kundërshtim me ligjin. Vendimi nr.179, datë 20.09.2013 i Komisionit të Shërbimit Civil që ka arritur në të njëjtin përfundim është i drejtë, i bazuar në prova dhe në ligj dhe për këtë arsye duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50/b të ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative".

VENDOSI :

- Lënien në fuqi të vendimit nr.179, datë 20.09.2013 të Komisionit të Shërbimit Civil.
- Ky vendim është i ekzekutueshëm nga shërbimi përmbartimor gjyqësor.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Tiranë, më 06.03.2014.


ANËTAR

Artur MALAJ



ANËTARE

Lindita SINANAJ



KRYESUESE

Altina NASUFI

